



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:015994

Datë: 24.12.2020

Numri i dokumentit: 01368652

C.nr.142/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen kontestimore të paditëses Z. S nga Gjilani, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. Taulant Ismajli nga Prishtina..., ndaj të paditurës S. i P. ... në Gjilan, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj me autorizim S. A nga Gjilani, me objekt kontesti, pagesa e shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 15.12.2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Z. S nga Gjilani, dhe detyrohet e paditura S. i P. ... në Gjilan, që paditëses t'ia paguajë dy (2) paga jubilarë në shumë të përgjithshme prej 754 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e pranimit-dorëzimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 260.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses në shumë prej 218,68 €, e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar **refuzohet si e pa bazuar** .

A r s y e t i m i

Paditësja Z. S nga Gjilani, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë më datë 04.02.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës S. i P... Gjilan. Në përmbajtjen e padisë ka theksuar se e njëjta është punëtore e S. i P... Gjilan , e përcaktuar në detyrat e punës ...ku edhe i realizon të ardhurat personale nga kontrata e punës me kohë të pacaktuar, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e saj dhe të detyrohet e paditura S. i P... Gjilan., që paditëses t'ia paguajë dy (2) paga jubilarë mujore në shumë të përgjithshme prej 972.68 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë me datën 26.02.2020, ka nxjerrë aktvendim për përgjegje në padi, të cilin i padituri e ka pranuar më datë 27.02.2020 (e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës), me të cilin aktvendim gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë po që se nuk paraqet përgjegje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes së saj.

E paditura pas pranimit të këtij aktvendimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkuespudinë e paditëses duke theksuar se kjo kërkesë është pa bazë ligjore për faktin se paditësi nuk ju ka drejtuar punëdhënësit për realizimin e të drejtës të cilën e kërkon, paditësi nuk i ka shterur mjetet juridike të cilat i parasheh procedura administrative, por në mënyrë të drejtëpërdrejtë të njëjtën synon ta realizojë përmes Gjykatës.

I autorizuari i paditëses në shqyrtimin kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses si dhe provave të ofruara, duke theksuar se paditësja ka përvojë pune mbi 20 vite, e me këtë ka fituar të drejtën në kompensimin e dy pagave jubilarë, ndërsa bazën juridike e mbështet në neni 17, paragrafi 3 pika 3.2 të kontratës kolektive sektoriale në shëndetësi e cila është në fuqi nga data 18.06.2018 dhe në fund ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpudinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar në ligj. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe ato: për përpilimin e padisë shumë prej 104€, për një seancë gjyqësore shumë prej 135€ si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21€, të gjitha në shumë prej 260 €.

I autorizuari i të paditurës në shqyrtimin kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpudinë e paditëses si të pabazuar, duke theksuar se është e vërtetë se paditësja në SPGJ, ka filluar punën me dt. 26.07.1999 dhe ka përvojë pune mbi 21 vite, çka nuk është kontestuese, mirëpo vlera e kërkuar prej 972.68 €, është kontestuese pasi që janë llogaritur pagesa nga përvoja e punës, kujdestaritë dhe shtesat e tjera, e që realisht paga duhej të llogaritej në vlerë prej 754 €, duke pas parasysh dy pagat mujore, po ashtu ka cekur se si organizatë publike kanë buxhet të ndarë prej 820.000 €, ku janë të përfshira të gjitha kategoritë e shpenzimeve, mirëpo Ministria e Shëndetësisë që e ka lidhur kontratën me F. e S. e cila i obligon institucionet shëndetësore që ta zbatojnë një marrëveshje të tillë me rastin e aprovimit të buxhetit nuk kanë ndarë mjete buxhetore për këtë kategori. Andaj në pamundësi për sigurimin e pagesave të pagave jubilarë kërkojnë nga gjykata që të merr aktgjykim refuzues për paditësen.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar

këto prova materiale: Kontratën e punës me nr. ... e dt. 31.12.2012; Vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. ... e dt. 20.11.2019; Pasqyrën bankare e dt. 03.11.2019 nga P.C B ... në emër të paditëses.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paditësja është në marrëdhënie pune në S. i P... Gjilan. në vendin e punës Infermiere – tani kryeinfermiere, në R. e O që nga 26.07.1999 dhe vazhdon të punojë edhe më tutje, fakte këto që vërtetohen nga kontrata e punës për kohë të pacaktuar me nr. 1986 e dt. 31.12.2012, si dhe vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. ... e dt. 20.11.2019.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuse se paditësja ka filluar punën në pozitën e infermieres në S. i P... Gjilan., para 21 viteve, po ashtu nuk është kontestuse se e nja ka një përvojë pune mbi 21 vite, nuk është kontestuese as baza ligjore, por për të paditurën kontestuse është se e njëjta nuk ka mjete financiare për të paguar shpërblimin jubilar të paditëses.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, konkretisht nenin 17 paragrafi 3 pika 3.2 e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar *“Punëtorët shëndetësor, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është që paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.*

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar konform nenit 382 të LMD, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se *„Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”* kurse lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu pjesën tjetërt të kërkesëpadisë së paditëses në shumë prej 218,68 € e kërkuar me tepër se shumata e gjykuara e refuzojë si të pabazuar, kjo për faktin se paga bazë e Infermiereve është 377.00 €, e jo siq pretendon i aturizuar i paditëses 486.34 €.

Gjykata duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104€, për një seancë gjyqësore shumë prej 135 € si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21€, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 260 €.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 142/20, me datë 15.12.2020

Gjyqtarja
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimin të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.